REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE SHËNDETESORE DHE STREHIMIT
SEKTORI I NDIHMËS EKONOMIKE DHE PAGESAVE

PROJEKT – VENDIM

Nr 3 .Datë 22.01.2026.

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKNOMIKE PËR FAMILJET APLIKUESE, TË CILAT NUK JANË SHPALLUR PËRFITUESE NGA SISITEMI I PIKËZIMIT DHE QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLLOK –NDIHMËN EKONMIKE DERI NË 6% PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2026.

Bazuar në Nenin 8 pika 2, 9/1 pika 1/1 neni 24 neni 54, 55 të Ligjit Nr. 139/2015 date 17.12.2015 "Per Veteqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligjin Nr. 121/2016 "Për shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë" Ligjit Nr. 57/2019 "Për asistencën Sociale në Repblikën e Shqipërisë" i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 597 datë 04.09.2019 " Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe të përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" i ndryshuar, VKM Nr. 956 datë 07.12.2016 " Për përcaktimin e kritereve dhe të detajeve të formulës se unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike",VKM Nr.855 datë 26.12.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr.597, datë 04.09.2019,të këshillit të ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike " të ndryshuar, Udhëzimit Nr. 3 datë 17.02.2017 "Mbi zbatimin e vendimit Nr. 955 datë 07.12.2016 të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike"(i ndryshuar), Udhëzimit Nr. 4 datë 17.02.2017 "Për përllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike " I ndryshuar, Udhëzimit Nr. 5 datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok –ndihmën ekonomike deri ne 6%" I ndryshuar, VKB Nr. 9 datë 21.01.2025 " Për miratimin e kritereve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi I pikëzimit dhe që do të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi I kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6%",VKB nr. 8 datë 21.01.2025 "Për miratimin e kritereve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi I pikëzimit dhe që do të trajtohen me ndihmën ekonomike nga fondet e buxhetit vendor.

Adresa: Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9; Tel+35581122288; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com; web: http://bashkiadevoll.gov.al/

PROPOZOJ:

Kriteret e familjeve në nevojë të cilat do të perfitojnë nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në **6%**:

1. Familjet të cilat kanë aplikuar në sistemin elektronik të Ndihmës Ekonomike brenda tre muajve të fundit dhe nuk janë përzgjedhur si familje perfituese nga sistemi online i pikëzimit me arsyen e mosplotësimit të pikëve.

2. Familja para se të përzgjidhet për tu trajtuar nga ky fond, duhet të jetë verifikuar paraprakisht duke ju bërë vlerësimi i gjëndjes social-ekonomike nga një komision i ngritur nga Pëgjegjësi i Pagesave të Ndihmës Ekonomike dhe Administratorët Shoqërorë.

3. Familjet duhet të jenë familje në nevojë, në kushte të vështira social-ekonomike, pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme për të perballuar shpenzimet bazë të jetesës.

4. Familjet me beqarë/beqare të vetmuar të cilët kanë kaluar moshën aktive për punë dhe që jetojnë në kushte të veshtira ekonomike me të ardhura të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet bazë.

5. Familjet me k/familjarë të ve, të divorcuar apo familje në nevojë me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë ose të lartë.

6. Familjet me të moshuar që kanë probleme shëndetësore pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.

7. Të moshuar të cilët trajtohen me pagesë minimale pensioni rural ose urban, pagesë kjo e pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet bazë.

8. Fëmijët të cilët ndjekën arsimin e mesëm ose të lartë dhe janë të vetëm në certificate për shkak të problemeve sociale familjare apo raste fatkeqësie kur të dy prindërit kanë ndëruar jetë.

9. Familjet me dy anëtarë në çertifikatë të cilët kanë kaluar moshën aktive për punë dhe nuk kanë plotësuar moshën e pensionit për tu trajtuar me pagesë.

10. Çdo kategori tjetër familje në nevojë e cila nuk mund të plotësojë nevojat bazë jetike.

Ngarkohet për zbatim, Sektori Ndihmës Ekonomike dhe Pagesave në Bashkinë Devoll I cili ka hartuar projekt- vendimin.

1. Mbas miratimit në Keshillin Bashkiak, hyrja në fuqi do të bëhet , sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për "Vetëqeverisjen Vendore".

Konceptoi: B.Lata

Pranoi: Z.Sinani

Konfirmoi bazën ligjore:E.Avdo

Konfirmoi:A.Rushitaj

Kryetar I Bashkisë
Eduard Duro

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL